



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:194180

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05706193

C.nr.1011/2022

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Saranda Aliaj në çështjen juridike civile të paditësit K.B nga M.K.S, mësimdhënëse në SH.F.M.U “Edit Durham” në M, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.S. H nga S Rr”Mulla Nura” pa nr. ndaj të paditurës K e S – D e A, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor i K së S A. B, sipas padisë për kompensimin e pagës jubilarë, me dt.20.05.2024 bie këtë:

### **A K T G J Y K I M** **Pa shqyrtim kryesor**

**I.APROVOHET në tërësi e bazuar** padia dhe kërkesëpadia e paditësit K. B nga M. K. S.

**II.DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësit në emër të kompensimit të pagës jubilarë në shumë prej **236.18 euro**, me kamatë ligjore 8 % nga data e parashtrimit të padisë 21.09.2022 e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë 125€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi K.B nga M.K.S, mësimdhënëse në SH.F.M.U “Edit Durham” në M, pranë kësaj Gjykate me datë 21.09.2022 përmes të autorizuarit të saj av. S. H, ka parashtruar padi kundër të paditurës K e – D. K e A, për pagesën e kompensimit të pagës jubilarë për 17 vite, 4 muaj, 9 ditë

përvojë pune, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt.13.11.2023 nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit meqenëse paditësi me prova materiale e ka vërtetuar vijueshmërin – e ditëve në punë, propozoj gjykatës që të njejtën ta aprovoj si të bazuar pa hapur seancë dhe shqyrtim me qëllim të ikjes së shpenzimeve të procedurës.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”* Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Nga analizimi i përgjigjes në padi rezulton fakti se e paditura nuk i ka kontestuar faktet vendimtare të kërkesëpadisë, me ç’rast për gjykatën është sajuar e drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetmën arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

E autorizuar e paditësit, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e pagës jubilarë i ka bashkëngjitur padisë kontratën e punës me nr. protokoli 162 e datës 01.09.2015, vërtetim nr.prot 213i lëshuar nga SH.F.M.U “Edit Durham” me datë 10.08.2022 .

Bazuar në provat e lartëcekura, shihet se kërkesa e paditësit për pagesën e pagës jubilarë për 17 vite,4 muaj,9 ditë përvojë pune, gjen mbështetje të plotë në nenin 35 paragrafin 8 nën par. 8.3.të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2015 dhe 2017. në të cilën thuhet: “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë:

- 8.1. për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë.
- 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë.
- 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë.
- 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë
- 8.5. shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërbilimit sipas kriterëve përkatëse.
- 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”.

Gjykata vendosi dhe obligoi të paditurën K e S – D. K të A, në S, që paditësit t’ia kompenzojë pagën jubilarë prej një page bazë për 17 vite,4 muaj,9 ditë përvojë pune në vlerë prej **236.18 euro** me kamatë ligjore 8 % nga data e parashtrimit të padisë 21.09.2022 e deri te pagesa definitive të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 35 paragrafi 8, nën par. 8.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2015 dhe 2017.

Gjykata besimin e plotë i fali provave që ka prezantuar paditësi, konkretisht kontratës së punës me nr. protokoli Suharekë për vijueshmërinë e tij në punë si dhe përgjigjes në padi të përshkruara si në dispozitiv

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 35 pika 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së

Gjykata Aktgjykimin e muarr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,  
C.nr.1011/2022 dt.20.05.2024**

**Gjyqtari  
Robert Tunaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.